

VENDIM
Nr.810, datë 6.10.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NDËRMJET PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, shpenzime kapitale, të zbritet fondi prej 84 229 000 (tetëdhjetë e katër milionë e dyqind njëzet e nëntë mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, të shtohet fondi prej 77 978 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, të shtohet fondi prej 6 251 000 (gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë e një mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha